

VENDIM
I ASAMBLESË SË ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË
ENGINEERING DESIGN PROTOTYPE SHPK

Nr. Vendimi: 08/2022

Nr. Prot.: 05 . 2022

Data/Ora e mbledhjes 23.03.2022 / 09:00

Sot, datë 23 Mars 2022, në selinë e shoqërisë në Rezidenca Imperial, Lagjia Pavarësia, Bulevardi Ismail Qemali, Pallati Anakonda, Kulla 1, Kati 2, Dyqani 32, Vlorë; u mbajt mbledhja e Asamblesë së Ortakut të vetëm, të shoqërisë "Engineering Design Prototype" shpk, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, në datën 10 Shkurt 2020 dhe e regjistruar me numër unik M06410202A, për të diskutuar këtë rend dite:

Cështjet e rendit të ditës:

1. Disa ndryshime në objektin e aktivitetit të shoqërisë.
2. Të tjera (propozime nga Ortaku i Vetëm/nëse ka).

Pjesëmarrës në mbledhje është Znj. Maria Fejzaj, ortak i vetëm dhe drejtues i mbledhjes. I pranishëm në mbledhje, pa të drejtë vote, është dhe Znj. Stela Vero, me numër identifikimi Nr. J55224062B, e cila është caktuar të mbajë procesverbalin e mbledhjes.


Meqenëse kuorumi i nevojshëm plotësohet, mbledhja u deklarua e mbajtur rregullisht për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës të përmendur më sipër.


Pasi shqyrtoi të gjitha çështjet, në përputhje me parashikimet e Nr. 9 901, datë 14.4.2008 *Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*, të ligjit Nr. 9 723, datë 3.5.2007 *Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit* dhe të Statutit të shoqërisë, Asambleja/Ortaku i Vetëm,


VENDOSI:

1. Shtimin e objektit të aktivitetit të shoqërisë "Engineering Design Prototype" shpk, duke përfshirë: *"Zhvillimin dhe/ose dhënien me qira për organizimin e panairëve dhe ekspozitave tregtare lokale, përfaqësimin brenda dhe jashtë Shqipërisë të kompanive të ndryshme kombëtare dhe rajonale, për të promovuar mallrat dhe shërbimet e ofruara nga sipërmarrësit shqiptarë dhe të huaj, për të nxitur investimet, eksportet vendase, si dhe për të përhapur njohuri mbi risitë teknologjike e shkencore të sektorëve të ndryshëm prodhues dhe të shërbimit."*
2. Autorizohet Sekretarja e Mbledhjes, Znj. Stela Vero, të bëjë depozitimin e këtij Vendimi ne QKB dhe në Organet tatimore.

Meqenëse nuk ka më çështje për tu diskutuar, mbledhja mbyllet. Ky vendim u mbajt në dy kopje identike dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.

Maria Fejzaj 
Ortak i Vetëm, Administrator

Stela Vero 
Sekretar i Mbledhjes



Engineering Design Prototype shpk

Adresa: Rezidenca Imperial, Lagjia Pavarësia, Blv Ismail Qemali, Pll. Anakonda, Kulla 1, Kati 2, Dyqani 32, Vlorë
T: +355 693232349, E: info@edpshpk.com

Kapitali i nënshkruar dhe i paguar 100,000 Lekë


Stela Vero